

Njoftim për shtyp 28 Shtator 2020

Sot me datë 28.09.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor zhvilloi mbledhjen plenare të radhës në të cilën shqyrtoi disa çështje të rëndësishme. Më konkretisht:

Pas verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të emërimit, pasurisë dhe figurës, Këshilli vendosi kualifikimin për emërim të shtatëmbëdhjetë kandidatëve për magjistratë të cilët kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2019-2020.

Me këtë vendimmarje Këshilli hap rrugën për caktimin e vendeve vakante në gjykatat e rretheve të vendit si dhe emërimin e shpejtë të tyre, me qëllim evadimin e çështjeve gjyqësore si dhe shërbimin në kohë, me cilësi dhe profesionalizëm ndaj qytetarëve.

Në vijim të shqyrtimit të kandidaturave për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, Këshilli vendosi kualifikimin e magjistratëve znj.Klodiana Veizi dhe z.Enton Dhimitri, si dhe vijimin e procedurave të mëtejshme të emërimit.

Gjithashtu pas shqyrtimit të kushteve dhe kritereve ligjore për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Këshilli vendosi kualifikimin e magjistrates znj.Daniela Shirka si dhe vijimin e procedurave të mëtejshme të emërimit.

Këshilli vendosi caktimin me short të relatorit për zhvillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të magjistratit {...}.

Në përfundim Këshilli diskutoi mbi verifikimin e kushteve dhe kritereve ligjore për emërimin si gjyqtar në Gjykatën e Lartë të kandidatit të katërt nga radhët e juristëve të spikatur, shqyrtimi i të cilit u shty për një mbledhje tjetër.